



BASHKIA SKRAPAR

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Studim projektim për "Ndërtim i urës së Blezëncës, tip Bailey, Bashkia Skrapar"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 72242000-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 918 176 (dymilion e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Për pikën a.- në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26; për pikën b.-në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 83 “Sigurimi i ofertës”, pika 1 dhe 2, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, 2 dhe 3.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo kërkesë konsiderohet e plotësuar, nëse operatori ekonomik ofertues, është kualifikuar për kriteret e përgjithsme të kualifikimit, të përshkruara në pikën 1, sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të dorëzuar prej tij, në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, ofertuesi duhet të dorëzojë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar, për vitet financiare 2024, 2025, vlera minimale e të cilës të jetë sa 40% e vlerës së llogaritur të fondit limit që prokurohet, e shprehur në lekë **1,167,270** (njëmillion e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë) pa TVSH.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

(Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 1., pika 2. gërma c) dhe pika 3. e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.)

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme :

Për të provuar përvojën e mëparshme, ofertuesi duhet të dorëzojë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryer gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera e të cilës të jetë të paktën sa 20% e vlerës së llogaritur të fondit limit që prokurohet, e shprehur në lekë **583,635** (pesëqind e tetëdhjetë e tremijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) pa TVSH. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike:

- Vërtetim për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- Faturë tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat:

- Faturë tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

(Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe nenin 41 pika 3. dhe nenin 55, pika 4, gërma b) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.)

2.3.2. Licenca profesionale

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, ofertuesi duhet të paraqesë:

Licencën profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, me katëgoritë e mëposhtme:

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

- b) Ura dhe vepra arti mbi 10 m - Estakada.
- c) Ura metalike.

8. PROJEKTUES GJEODET

- a) Bazamente gjeodezike – rivelime në të gjitha shkallët.

10. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË

- e) Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

- a) Sinjalistikë në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

Argumentimi:

(Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 ”Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar.)

(Licensat e mësipërme, janë kërkuar nga ana e Autoritetit kontraktor për shkak se lidhen ngushtë me objektin e prokurimit, dhe kërkesët e detyrës së projektimit (termat e referencës) si më poshtë:

Kat. 7. b) Objekti i prokurimit është projektim ure me gjatësi 27m, pra më të madhe se 10m.

Kat. 7. c) Objekti i prokurimit është projektim ure metalike tip Bailey.

Kat. 8. a) Në detyrën e projektimit është kërkuar *Plan rievimi në shkallën 1:500.*

Kat. 10. e) Në detyrën e projektimit është kërkuar *Projekti i ndriçimit të urës nëse është e mundur një pikë lidhje e afërt për energjinë.*

Kat. 11. a) Në detyrën e projektimit është kërkuar *Planimetritë e vijëzimit të urës dhe shenjave të trafikut në të dy anët e urës.*

2.3.3. Stafi dhe punonjësit

Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar pranë shoqërisë me kohë të plotë dhe të figurojnë në licencën e shoqërisë për Studim – Projektim, Drejtuesit Teknikë të kërkuar më poshtë:

- Inxhinier ndërtimi/ rrugë-hekurudha/konstruktor 1 (një)
 - Inxhinier elektrik 1 (një)
 - Inxhinier gjeodet/topograf 1 (një)
-

Për këtë duhet të parqitet

- një listë të drejtuesve teknikë të kërkuar më sipër, përfshirë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës;
- deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë, nga secili inxhinier i kërkuar më sipër.
- listë pagesat e punonjësve të shoqërisë të siguruar për muajin Maj 2026 (Formularët E-Sig 025/a.1), në të cilën duhet të figurojnë punonjësit e mësipërm.

Argumentimi:

(Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4 gërma b), c), d), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Inxhinierët drejtues teknik që janë kërkuar, përputhen me kategoritë e kërkuara të licencës së subjektit dhe argumentimin e bërë në pikën 2.3.1, sipas kriterëve të përcaktuara në VKM-në nr.759 datë 12.11.2014 *"Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", i ndryshuar.*

2.3.4. Mjetet dhe pajisjet

Operatori ekonomik, duhet të ketë mjetet dhe pajisjet e nevojshme për të realizuar shërbimet e kërkuara sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit (termat e referencës), si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Sasia	Pronësia
1	Paisje Total Station, ose GPS, ose Dron	1 (një)	Në pronësi ose me qera

Për paisjet e kërkuara më sipër të paraqitet:

- faturë tatimore e shitjes, në rastin kur janë në pronësi
- kontratë qeraje e noterizuar në rastin kur janë me qera
- foto të tyre.

Argumentimi:

(Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 gërma ç) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe paisjet teknike e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- Paisje Total Station, ose GPS ose Dron, është kërkuar pasi është i nevojshëm për hartimin e planit rilevimit në shkallën 1:500, sipas kërkesës së detyrës së projektimit në “2.FAZA III: Projektideja përfundimtare”, pika 2.1.

3. TË PËRGJITHSHME

Pavarësisht sa përcaktohet në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe të paraqitura nga ofertuesi në formularin përmbledhës të deklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE TERMAT E REFERENCËS

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Skrapar, ka hartuar Detyrën e Projektimit, e cila është miratuar nga titullari i Autoritetit Kontraktor dhe në të cilën janë trajtuar, të gjitha kërkesat në lidhje me realizimin e shërbimit të “**Studim projektim për "Ndërtim i urës së Blezënckës, tip Bailey, Bashkia Skrapar"**”.

Janë përcaktuar:

- Objekti (përshkrimi i gjendjes egzistuese).
- Qëllimi i shërbimeve
- Kërkesa të veçanta
- Fazat e shërbimeve
- Vizatimet
- Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar
- Përmbajtja e projektit të zbatimit
- Paraqitja e vizatimeve
- Preventivi i punimeve
- Dorëzimi i dokumentacionit (mënyra e dorëzimit të shërbimeve)
- Afatet e realizimit të shërbimeve

Detyra e Projektimit, do të jepet bashkëlidhur dokumenteve të tenderit.

Për pasojë, kërkesa e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e plotësuar.

KRITERET E VLERËSIMIT

Njësia e prokurimit pasi u njoh me “Detyrën e Projektimit”, “Procesverbalin për llogaritjen e Bazës së Projektit” dhe “Procesverbalin e llogaritjes së fondit limit”, të hartuar nga grupi i punës ngritur me urdhër nr. 203 datë 26.05.2026 “Për hartim detyrë projektimi, bazës së projektit dhe llogaritjen e fondit limit” për : Studim-Projektim për "Ndërtim i urës së Blezënckës, Tip Bailey , Bashkia Skrapar", në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 87

“Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, si dhe VKM-së nr.354 datë 11.05.20156 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, vendos që kriter i vetëm i vlerësimit të jetë:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin **më të ulët të ofertës, brenda vlerës minimale dhe maksimale**, siç përcaktohet në VKM-së nr.354 datë 11.05.2016 "Manuali i tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim", për **Klasën Veprat inxhinierike, Grupi Tarifor III**.

Argumentimi:

(Në zbatim të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 3. ku përcaktohet “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave”, si dhe VKM-së nr.354 datë 11.05.20156 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”).

PËRFUNDIME

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit, si dhe specifikimeve teknike, njësia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte të Tenderit, për procedurën **e hapur të thjeshtuar shërbime**, me objekt prokurimi “**Studim projektim për "Ndërtim i urës së Blezënkës, tip Bailey, Bashkia Skrapar"**". Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së.

NJËSIA E PROKURIMIT

Altin Lamçe

Benis Dosti

Florand Osmani
